



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2021:249908

Datë: 30.01.2024

Numri i dokumentit: 05259569

C.nr 8722/21

GJYKATA THEMLORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “K...” Sh.a, me adresë në Prishtinë, kundër të paditurit K. M nga komuna e Obiliqit, me objekt kontesti kompensimin dëmit material, vlera e objektit të kontestit 219.28 euro, jashtë seancës, me datën 30.01.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË MOSBINDJES

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses “K...” Sh.a me seli në Prishtinë ashtu që DETYROHET i padituri K. M nga komuna e Obiliqit, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 219.28 euro, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga dita e parashtrimt të padisë (08.11.2021) e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, me datën 08.11.2021 ka paraqitur padi kundër të paditurit K. M nga komuna e Obiliqit, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material të shkaktuar me keqpërdorim të energjisë elektrike. Në padi ka theksuar se i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar me aktgjykim penal të formës së prerë për shkak se në shtëpinë e tij në, me qellim që vetit ti sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar ashtu që bërë kyçje direkte në rrjetin elektrik, me ç’ rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në shumë prej 219.28 euro. Në fund ka kërkuar nga gjykata që padinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më datën 27.01.2022, të cilin i padituri e ka pranuar me datën 07.02.2022 (e cila është konfirmuar përmes fletëkthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestimore, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ke gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga se neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, ku është përcaktuar se gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë në rastet kur të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë, respektivisht fatura për shkaktimin e dëmit me numër DPRHP 1912844 e datës 13.12.2019, si dhe aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër P.nr.1126/20 i datës 09.03.2021, ka gjetur se i padituri K. M me datën 12.12.2019 në shtëpinë e tij në e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjet elektrike pa matje, me ç 'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në shumë prej 219.28 euro, për të cilin dëm paditësja është udhëzuar ta realizojë në kontest të rregullt civil.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.1126/20, i datës 09.03.2021, i formës së prerë me datën 11.05.2021, gjykata gjeti se i padituri është shpallur fajtorë për veprën penale vjedhje e shërbimeve, për shkak se prej datës së pavërtetuar e deri më datën 12.12.2019 në shtëpinë e tij, e ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, duke u kyçur në mënyre të drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik dhe duke anashkaluar njësinë elektrike për matjen e konsumit, me që rast paditëses KEDS i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 219.28.

Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës gjykata duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.1126/20, i datës 09.03.2021, i formës së prerë me datën 11.05.2021, si dhe bazuar në faturën për shkaktimin e dëmit numër DPRHP1912844 e datës 13.12.2019 e paditëses, dhe faturës së kalkulimit të rikthimit të humbjeve me numër 11888, të datës 13.12.2019, me të cilën është kalkuluar se si rezultat i mos regjistrimit të paditurit në njësinë elektrike, i ka shkaktuar dëm paditëses në shumën prej 219.28 euro të cilin dëm edhe gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e obligoj të paditurin t'ia kompensoj paditëses.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 14 i LPK-së ku thuhet se “*Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”, e në lidhje më dispozitat nga neni 136, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e

Detyrimeve (LMD) – ku përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”* – gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 08.11.2021.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitivin nga neni 452 të LPK - së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumë prej 20.00 euro i referohet shpenzimeve për taksë gjyqësore për padi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform nenit 150 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr 8722/21, datë 30.01.2024

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi konform nenit 491 të LPK-së është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*